



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 57, Datë 16.02.2021**

**PËR**  
**FILLIMIN E PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES PËR NGRITJEN**  
**NË DETYRË NË GJYKATËN E APELIT DURRËS, PËR POZICIONIN E LIRË**  
**NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 173,**  
**DATË 28.05.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 8 dhe 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 24, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, mbas shortit për zgjedhjen e relatorëve,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 173, nr. datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Caktimin e z. Ilir Toska, si relator për këtë procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**